



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
04/2020
Klinë, dt.16.03.2020

Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, si dhe vendimin nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, me akordimin edhe të grupit për gatishmëri emergjente të datës 16.03.2020, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 16.03.2020, merr;

V E N D I M

1. **AUTORIZOHET**, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente që të angazhojë staf shtesë prej se paku 5 personave më punë dhe detyra specifike, për mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e ambienteve dhe objekteve publike dhe private të frukuentueshme nga qytetaret.
2. Stafit të angazhuar të ju lëshohen kontrata për shërbime specifike për një periudhë të caktuar të nevojshme më mundësi vazhdimi.
3. Vendimi i është i plotfuqishëm dhe do të zbatohet menjëherë.
4. Zbatimi i këtij vendimi behet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente.

Te njoftohet:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente;
- Grupi për gatishmëri emergjente;
- Publiku.

